UDHËZIM
Nr.2306, datë 10.12.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.2365, DATË 26.11.2008 "MBI ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.277,D ATË 18.6.1997 "PËR PËRFITIMIN NGA STATUSI I TË VERBRIT", I NDRYSHUAR"

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në bazë të pikës 16 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.277, datë 18.6.1997 "Për përfitimet nga statusi i të verbërit", të ndryshuar

UDHËZOJ:

Në udhëzimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta nr.2365, datë 26.11.2008 "Mbi zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.277, datë 18.6.1997 "Për përfitimin nga statusi i të verbërit", i ndryshuar", bëhen këto ndryshme:

1. Germa "a" e pikës 2, ndryshon si më poshtë:

"a"Certifikatë personale ose kopje të letërnjoftimit, e cila ripërtërihet çdo fillim viti.

2. Germa "f" e pikës 2, ndryshon si më poshtë:

"f' Kopje e noterizuar e letërnjoftimit, kur kujdestari është i zgjedhur jashtë familjes.

3. Përmbajtja e pikës 17 ndryshohet si më poshtë:

"17 Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror pajis me librezën e re të verbërisë të gjithë personat e verbër. Afati i vlefshmërisë së librezës është në përputhje me afatin e komisionimit, të përcaktuar në vendimin e KMPV-së".

4. Në pikën e 20 të udhëzimit, pas togfjalëshit "certifikatë personale me fotografi…" shtohet togfjalëshi: "…ose kopje të letërnjoftimit".

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA
Spiro Ksera